



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 52, date 19.07.2018

PËR DHËNIE PËLQIMI PËR DHËNIE ME QIRA TË EKONOMISË PYJORE/KULLOSORE: “LUGINA E KIRIT“ NJËSIA ADMINISTRATIVE PULT, NGA STRA 189/b ME SIPËRFAQE 250 M² ME AFAT 5-VJEÇAR DHE EKONOMISË PYJORE/KULLOSORE “LUGINA E SHALËS 2“ NJËSIA ADMINISTRATIVE SHALË, NGA STRA 31/b ME SIPËRFAQE 250 M² ME AFAT 5-VJEÇAR PËR VENDOSJEN E ANTENAVE TË KOMPANISË TË TELEFONISË CELULARE TELEKOM ALBANIA SH.A.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 19.07.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e”, nenin 55 pika 4 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 19 të ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar, VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, pika 2 e VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar, pika 22 germa “g” e Udhëzimit nr. 1, datë 9.6.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërimit, shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”,

V E N D O S I :

1. Dhënien e pëlqimit për dhënie me qira të ekonomisë pyjore/kullosore “Lugina e Kirit” njësia administrative Pult, ngastra 189/b me sipërfaqe 250 m² me afat 5-vjeçar për vendosjen e antenave të komunikimit të telefonisë celulare “Telekom Albania” sh.a, sipas planimetrisë bashkëlidhur.
2. Dhënien e pëlqimit për dhënie me qira të ekonomisë pyjore/kullosore “Lugina e Shalës 2” njësia administrative Shalë, ngastra 31/b me sipërfaqe 250 m² me afat 5-vjeçar për

vendosjen e anetave të komunikimit të telefonisë celulare “Telekom Albania” sh.a, sipas planimetrisë bashkëlidhur.


3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 19.07.2018


Shpallur në datën 20.07.2018

Sekretar i keshillit




Suel Hadri

KRYETAR




Xhemal BUSHATI





Antena Shale 2
Antena

FRAGMENT HARTE, EP."LUGINA E KIRIT", PARCELA 189/b KU ASHTE ANTENA ETEL.CELULARE



A. Xhanit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 944/1 prot

Shkodër, më 26.07.2018

LËNDA: Mbi vendimin nr. 52, datë 19.07.2018 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016, dt 2.10.2016 "Për Prefektin", shqyrtoi vendimin **nr.52, datë 19.07.2018 të Këshillit Bashkiak Shkodër "Për dhënie pëlqimi¹ për dhënie me qera, ekonominë pyjore/kullosore ngastra 189/b "Lugina e Kirit" NJAD Pult dhe ekonomia pyjore/kullosore 31/b "Lugina e Shalës 2" NJAD Shalë, për vendosje të antenave të telefonisë celulare"- sipas relacionit të detajuar të shtrukturës përgjegjëse e pyjeve & kullotave në bashki.**

Prefekti në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.2, nenit 27, pika 5, nenit 36, nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 4 e Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit nr.115/2014, datë 31.07.2014 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 për "Pronat e paluajtshme të shtetit" (i ndryshuar); Ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për Pyjet dhe shërbimin pyjor" (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për Transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive" pika 48-shtojca 46, pikat 1, 2, 3, 4, 22, gërma "g" e Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat e procedurave të kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", ju lejon procedimin e mëtejshëm ligjor për VKB nr. 52, datë 19.07.2018.

Me respekt,

PREFEKTI

Çesk MILLIA

¹terminologjia dhënie pëlqimi në parim për dhënie me qera nuk ka referencë ligjore nenin 54, gërma "g" sipas ligjit nr.139/2015. Kjo dispozitë citon këshilli bashkiak (i cili ushtron të drejtën e pronësisë) miraton transferimin e dhënien në përdorim të pronës, në mbështetje të relacionit të detajuar të përgatitur nga struktura përgjegjëse e pyjeve dhe kullotave. cmërtimi i saktë

Pr. 12250 26.07.2018